

# RELACION

## PËR

### AKTIN NORMATIV “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.88/2019 “PËR BUXHETIN E VITIT 2020, I NDRYSHUAR”

#### A. MËNYRA E NDËRHJRJES

Ky akt normativ propozohet në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës. Në këtë dispozitë kushtetuese parashikohet që Këshilli i Ministrave ka të drejtën e nxjerrjes së këtyre akteve normative me fuqinë e ligjit.

Akti normativ, gjithashtu, plotëson të gjitha kriteret e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, veçanërisht vendimi nr.24, datë 10.11.2006, vendimi nr.23, datë 16.4.2014, etj. Konkretisht, për miratimin e një akti normativ kërkohet të plotësohen kushtet që vijojnë<sup>1</sup>:

1. *Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit;*
2. *Përkohshmëria e masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit;*
3. *Fuqia ligjore e këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre;*
4. *Miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi.*

#### **1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit;**

Neni 101 ka parashikuar ‘**nevojën**’ dhe ‘**urgjencën**’ si rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë procesin dhe ka përgatitur skenarin e rishikimit të buxhetit 2020. Ky rishikim propozohet t’i nënshtrohet procedurës së aktit normativ, aspekti i nevojës dhe emergjencës të së cilit lidhet me financimin e paketës së dytë të masave anti-COVID19 të qeverisë dhe konkretisht:

- ✓ *Përmes një alokimi shpenzimesh në masën 7 miliardë lekë për këtë qëllim;*
- ✓ *Përmes miratimit të një garancie sovrane në masën 15 miliardë lekë.*

Njëkohësisht, **nevoja dhe urgjenca** konsiston edhe në faktin se si rezultat i gjendjes aktuale të emergjencës shëndetësore, ky akt normativ synon:

- a) *Të reflektojë një reduktim në masën -63.1 miliardë lekë të planit të arkëtimit të të ardhurave buxhetore, kundrejt planit fillestar 2020, si rrjedhojë e impaktit negativ të pandemisë Covid-19, ku pjesën kryesore e zë reduktimi i të ardhurave tatimore me rreth -57 miliardë lekë.*

---

<sup>1</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr.24, datë 10.11.2006

- b) *Të reflektojë një rritje të shpenzimeve buxhetore prej rreth 30.16 miliardë lekë, me synim kryesor injektimin me financim të sektorëve prioritarë të ekonomisë, specifikisht përmes investimeve publike.*
- c) *Të reflektojë rritjen e deficitit buxhetor, për rrjedhojë, në nivelin -132.9 miliardë lekë ose rreth 8.4% e PBB-së, nga përkatësisht 39.7 miliard lekë ose 2.2% e PBB-së që ishin sipas buxhetit fillestar dhe nga 68.7 miliardë lekë ose rreth 3.9% në rishikimin e parë sipas aktit normativ nr.6/2020.*
- d) *Të reflektojë për rrjedhojë, rritjen e borxhit publik total në nivelin e pritur prej rreth 80% të PBB, nga rreth 65% të PBB që pritej sipas buxhetit fillestar dhe nga rreth 69% e PBB në rishikimin e parë sipas aktit normativ nr.6/2020.*

Rritja e borxhit publik total të pritshëm si raport ndaj PBB-së në këtë akt normativ, kundrejt buxhetit fillestar reflekton:

- i) *rritjen e deficitit buxhetor dhe huamarrjes totale neto;*
- ii) *rritjen e stokut të pritshëm të borxhit të garantuar;*
- iii) *reduktimin e PBB nominale të parashikuar.*

Rritja vetëm si rrjedhojë e reduktimit të PBB-së nominale të parashikuar nga buxheti fillestar është rreth 8 pikë përqindje.

Ndërkohë, ndryshe nga rregulli fiskal i përcaktuar në ligjin organik të buxhetit për targetimin e një niveli të borxhit publik më të ulët sesa një vit më parë, devijimi i përkohshëm nga ky rregull fiskal në këtë akt normativ, ku borxhi publik i pritshëm për vitin 2020 prej rreth 80% e PBB-së është më i lartë sesa ai i vitit 2019 prej 66% të PBB-së, është në përputhje me një prej rasteve të rrethanave të jashtëzakonshme, përcaktuar në nenin 4/4, shkronja “a”, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, i ndryshuar, rast në të cilin qeveria mund të devijojë përkohësisht nga rregulli fiskal i sipërpërmendur.

## **2. Përkohshmëria**

Akti normativ vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë kohe, maksimalisht 45-ditore. Përkohshmëria e këtij akti lidhet me kushtin e domosdoshëm të shqyrtimit të tij nga Kuvendi, i cili nëse e miraton, e kthen atë në ligj. Për këtë arsye, menjëherë pas miratimit të aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Këshilli i Ministrave, ky akt do të dërgohet për miratim në Kuvend, me qëllim fillimin e procedurave parlamentare përkatëse.

## **B. QËLLIMI I HARTIMIT TË KËTIJ PROJEKTAKTIT**

Referuar alokimeve më të rëndësishme, akti normativ përcakton:

### **Shpenzime korrente:**

- ✓ *Financimin shtesë në masën 900 milionë lekë të nevojës së NJVQV-ve për bonusin e qirasë sociale në kuadër të tërmetit të datës 26.11.2019, deri në fund të vitit 2020.*
- ✓ *Alokimin e fondit shtesë prej 400 milionë lekësh për skemën e fermerëve, bazuar në tejkalimin e pritshërive të MBZHR-së për aplikimet e vitit 2020.*
- ✓ *Financimin në masën 400 milionë lekë të programit të ri të anglishtes dhe IT-së për ciklin e ulët.*
- ✓ *Alokimin e një fondi prej 200 milionë lekësh, si parakusht për përthithjen e mbështetjes buxhetore të BE-së në kuadër të projekteve IPA.*
- ✓ *Rritjen me 200 milionë lekë të fondit të planifikuar për skemën e papunësisë, si rrjedhojë e parashikimeve dhe pritshmërive deri në fund të vitit 2020.*
- ✓ *Sigurimin e organikës së mjaftueshme për strukturën e re të OFL-së prej 87 efektivësh, me një kosto prej 40 milionë lekësh.*
- ✓ *Rritjen e strukturës organike të Policisë së Shtetit me 500 efektivë të rinj, pa kosto shtesë në buxhet.*

### **Shpenzime kapitale:**

- ✓ *Alokimin e fondit në masën 4 miliardë lekë për shpenzime shpronësimi dhe shlyerje detyrimesh të prapambetura në sektorin e infrastrukturës.*
- ✓ *Financimin shtesë prej 1 miliard lekësh për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve në shkallë vendi.*
- ✓ *Alokimin e fondit shtesë prej 3 miliardë lekësh për FSHZH, për programe zhvillimi.*
- ✓ *Alokimin e fondit prej 2 miliardë lekësh për projektin madhor të Unazës së Re të Tiranës.*
- ✓ *Financimin e projektit të Rrugës së Ersekës, në masën 800 milionë lekë.*
- ✓ *Financimin prej 600 milionë lekësh të studim-projektimit të tunelit të Llogarasë.*
- ✓ *Financimin prej 500 milionë lekësh të studim-projektimit të konvikteve nga Bashkia Tiranë.*
- ✓ *Financimin e By-Pass-it Tepelenë, në masën 300 milionë lekë.*
- ✓ *Akordimin e një fondi prej 573 milionë lekësh për blerjen e pajisjeve e përshtatjen e godinës së SPAK.*

- ✓ *Alokimin e fondit shtesë prej 100 milionë lekësh për projektet e kanaleve ujitëse/kulluese.*
- ✓ *Financimin prej 73 milionë lekësh të studim-projektimit të aksit Sheshi Shqiponja-Bulevardi i ri.*

Parashikimet kuantitative për impaktin negativ të COVID-19 në ekonomi ende mbeten të rrethuara nga një marzh i lartë paqartësie. Pritet që impaktin më të lartë negativ ta kenë aktivitetet ekonomike që lidhen me sektorët e turizmit, transportit, tregtisë. Gjithashtu, pritet të preken konsiderueshëm edhe sektorët e industrisë përpunuese, industrisë nxjerrëse, shërbimeve të tjera dhe ndërtimit. Mundet që njëkohësisht disa sektorë të tjerë të kenë një impakt neto pozitiv, si p.sh. sektori i bujqësisë, kryesisht për shkak të efektit të zëvendësimit të mallrave të importit me ato të prodhuara në vend.

Ndërkohë nga pikëpamja e kërkesës agregate, impakti më i lartë negativ pritet në eksportet totale, sidomos ato të shërbimeve dhe në konsumin final. Ndërkohë, tkurrja në të njëjtën kohë e importeve, si të mallrave ashtu edhe të shërbimeve, pritet të zbusë në një masë të caktuar efektin neto negativ në rritjen reale të PBB-së.

Parashikimi i rritjes ekonomike, si dhe të gjithë variablave të tjerë makroekonomikë, me shumë gjasa do të jetë sërish subjekt rishikimesh në vijimësi të qartësimit të dinamikës së situatës. Megjithatë, në këtë akt normativ është parashikuar (supozuar) një rritje reale negative (recension) prej -4.3%, dhe rritje nominale negative prej -5.8% për vitin 2020, nga përkatësisht 4.1% dhe 5.2% të parashikuarara në buxhetin fillestar.

Në përfundim, është me rëndësi të theksohet se përkeqësimi i parametrave të financave publike është tërësisht rrjedhojë e dy goditjeve tepër të forta që mori vendi dhe ekonomia dhe imponohet nga domosdoshmëria që në rrethana të tilla të jashtëzakonshme të utilizohet funksioni stabilizues i buxhetit të shtetit, si instrument kryesor për të amortizuar një pjesë të efekteve të forta negative të shkatuara nga këto dy goditje. Ky përkeqësim i parametrave do të jetë i përkohshëm dhe në periudhën afatmesme politika fiskale do të rikthehet qartësisht drejt objektivit të saj prioritar të konsolidimit të qëndrueshëm fiskal.

## **KËSHILLI I MINISTRAVE**

### ***Shënime***

1. Lloji i shkrimit në të gjithë dokumentin është “*Times Neë Roman*”, madhësia e shkrimit 14, hapësira mes rreshtave 1.
2. Titulli i dokumentit “Relacion për ...lloji i projektaktit...titulli i projektaktit” dhe titujt e rubrikave shkruhen me shkronja të mëdha “***Bold***” me hapësirë 1 mes rreshtave, e vendosur në qendër.
3. Shkrimi në “*Footer*” është i madhësisë 11.